

---

## LIRIA E TË SHPREHURIT DHE LIRIA E MEDIAVE

---

>> Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mbajtjes së mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve përmes çfarëdo mediumi, pa marrë parasysh kufijtë. <<

### NENI 19, DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

#### TREGIM ILUSTRUES

*Ne kemi të drejtë natyrore që t'i përdorim pendat tona si dhe gjuhët tona, në rrezikun dhe skarificën tonë.*

#### **'LIRIA E SHTYPIT'** NË FJALORIN FILOZOFIK (1764)

*Si përgjigje e ngjarjeve tragjike në Teatrin e Moskës në tetor të vitit 2002, parlamenti rus shpejt miratoi – me kërkesë të presidentit rus- një ligj të ri, i disenjuar që ta lejojë qeverinë ruse ta kufuzojë raportimin e mediave mbi aktet terroristë në Rusi...*

*Dr. Manorani Saravanamuttu është nëna e Riçard de Zoysa, një gazetar i rrëmbyer dhe i vrarë në Sri Lankë në Shkurt të vitit 1990. Dr. Saravanamuttu ka bërë fushatë që të zbardhet e vërteta për vrasjen e djalit të saj. Ajo i ofroi autoriteteve informata që të ndërmarrin një hetim për vrasjen, por e vetmja gjë që ajo mori ndonjëherë ishte një letër që shkruante: "Mbaj zi për vdekjen e djalit. Si nënë ju duhet të bëni kështu. Çdo hap tjetër do të rezultojë me vdekjen tuaj në kohën më të papritur.... Vetëm heshtja do të të mbrojë ty." (Jan Bauer, Vetëm vdekja do të të mbrojë ty, Grua, Liria e të shprehurit dhe gjuha e të drejtave të njeriut, Qendra Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut dhe Zhvillimeve Demokratike, 1996.)*

*Në nëntor të vitit 2002 Qendra e te Drejtës Humanitare në Beograd informoi publikun se kryebashkiaku i këtij qyteti serb u kërcënua hapur për “vrasje dhe shkatërrim” kundrejt një gazetari dhe familjes së tij për shkak të raportimi për përzierjen e tij në marrëveshje të zeza biznesi. Kur artikulli u publikua gazetari u mor në pyetje nga policia që erdhën tek ai pa fletëbastisje. Ai po ashtu u padit për shpifje dhe dëme.*

## **PYETJE PËR DISKUTIM?**

1. Cilat të drejta të njeriut janë shkeluar dhe nga kush në tregimin e mësipërm?
2. Çfarë arsyes mund të justifikojnë kufizimin e lirisë së shprehurit dhe lirisë së mediave?
3. Çka duhet të bëhet për t'i mbrojtur këto të drejta në mënyrë më të mirë?
4. Çka mund të bëjnë viktimat e shkeljeve?
5. Çfarë janë obligimet e gazetarëve të përgjegjshëm?

## **E DOMOSDOSHME TË DIHET !?**

### **1. RËNDËSIA E KALUAR DHE E TANISHME**

Liria e mendimit dhe të shprehurit – përfshirë këtu edhe “*lirinë që të pranon dhe bart informata dhe ide për çfarëdo mediumi dhe pa marrë parasysh kufijtë*” (neni 19 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948) – është njëra nga të drejtat themelore politike dhe civile, e cila përputhet plotësisht me të gjithë instrumentet e të drejtave të njeriut. Ajo i ka rrënjët në luftën për liritë individuale të shekujve 18 dhe 19, kur ishte përfshirë në kushtetutat e SHBA-ve dhe ato evropiane. Filozofi britanik *Xhon Stjuart Mill* e emërtoi si liria e shtypit “*njëra nga siguritë kundër qeverisë tiranike dhe të korrumpuar*” (Mbi lirinë, 1859). Është po ashtu e drejtë konstituive për çdo qeveri demokratike në të cilën çdonjëri, jo vetëm qytetarët e shtetit, kanë të drejtën njerëzore të thonë se çka mendojnë dhe në të njëjtën kohë të kritikojnë qeverinë. Në janar të vitit 1941, kryetari Ruzvelt shpalli lirinë e të folurit dhe të shprehurit si njëren nga katër liritë mbi të cilat duhet të mbështetet rregulli botëror pas Luftës së Dytë Botërore. Qasja në një

rrjedhje të lirë të informatave përtej kufinjëve është një element i madh për një shoqëri të hapur dhe pluraliste.

### **Siguria Njerëzore, Liria e të Shprehurit dhe Mediave**

“*Liria nga frika*” po ashtu përfshin lirinë e të shprehurit të mendimeve tona dhe lirinë e mediave. Pasi koncepti i sigurisë njerëzore është po ashtu i bazuar në të drejtën e individit për të kërkuar dhe pranuar informata dhe ide të çdo lloji, përfshirë këtu ato kritika të fuqive sunduese, kërcënimi i gazetarëve dhe kontrolli përbëjnë njërin ndër kërcënimet më të mëdha kundër sigurisë njerëzore, kërcënime të reja për sigurinë njerëzore por edhe shansa të reja vijnë me “*teknologjitë e reja*”.

“*Lidhshmëria*” e re mund të përdoret për qëllime edukative, por edhe për krim të organizuar. Fushatat ndërkombëtare kundër minave fushore dhe ato për Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve janë bërë më të lehta, por rreziku i ri paraqitet në formën e një “*krimi kibernetik*”. Deri sa ekonomitë dhe shërbimet bëhen më të varura në teknologjitë e reja, format e reja të përfshirjes dhe përjashtimit kanë evoluuar. Për shembull, mediumet e bazuara në vijën e quajtur Organizata Mediale e Evropës Juglindore (OMEJL) është ankuar se Telekomit të Serbisë po aplikon “*kufizime*” në linjat e internetit të marra me qira, në mënyrë që t’i shtyjë mediat dhe të tjerët që të ndërrojnë ofruesin nga ai privat në atë të shërbimit të internetit të Telekomit të Serbisë.

>>Zotëri, unë nuk i ndaj mendimet me ju, por unë do ta rrezikoj jetën time për të drejtën tënde që t’i shprehësh ato.<<

### **VOLTAIRE (1694 – 1778)**

“Faktori CNN” i cili e sjell çdo konflikt në dhomën e pritjes ka ndërruar rolin e mediave. Për shkak të rëndësisë së opinionit publik, media është bërë një pjesë më e rëndësishme e luftës sesa që e kemi parë në rastin e Kosovës. “*Info luftërat*” dhe “*inforaknaqësitë*” qëndrojnë për prirjen që informacioni e ka nënrenditur në qëllime të tjera.

## **Sfidat e vjetra dhe të reja**

Liria e informimit, shprehjes dhe mediave kishte rëndësi të veçantë gjatë luftës së ftohtë, kur njerëzit në vendet socialiste të Evropës Lindore nuk kishin qasje në gazetatat apo revistat e huaja. Më vonë, qeveria kineze tentoi t'i ndalonte përdorimin e antenave satelitore në mënyrë që t'i ndalojë qytetarët e saj që t'i ndjekin kanalet televizive përendimore dhe sot disa vende kanë kufizuar qasjen në internet në mënyrë që t'i parandalojnë qytetarët e tyre që t'i shikojnë faqet e internetit të cilat ata i konsiderojnë si të padëshirueshme.

Media mund të ketë rol të dyfishtë si përfituese dhe shkelëse e lirisë së shprehurit. Roli mund të jetë informimi për problemet botërore, forcimi i solidaritetit global, por mund të jetë njëri ndër instrumentet e propagandës së shtetit për një interes të veçantë ekonomik apo interes tjetër. Sipas komisionit të UNESCO-s mbi kulturën dhe zhvillimin, teknologjitë moderne të komunikimit e kanë bërë të pamundshëm kontrollin e rrjedhës së informatave, ndikojnë në krijimin e shanseve të reja, por po ashtu përbëjnë kërcënime të reja, veçanërisht nëse media bëhet cak i sulmeve apo kontrollit politik. Diversiteti dhe kualiteti i programeve mund të zvogëlohet si rezultat i komercializimit, i etur për të pasur një audiencë më të gjerë, apo për të konkuruar për numër më të madh lexuesish dhe shikuesish, duke u koncentruar në seks dhe në tregime kriminalistike.

Kërcënimi më i madh për lirinë e mediave është bërë koncentrimi i mediave, i cili ekziston në të dyja nivelet - në nivelin lokal dhe në atë global. Prandaj, në shumë shtete dhe në Bashkimin Evropian ka ligje kundër koncentrimit të mediave në mënyrë që të ruajnë pluralizmin medial.

Sifda të mëtutjeshme dhe më të elaboruara të reja, të lirisë së informimit dhe mediave janë sjellë nga zhvillimi teknologjik, si shpërndarja e komunikimeve satelitore dhe rritja e qasjes në internet. Shumë shpesh shtete mundohen ta kufizojnë qasjen në mediat e reja, për shkak të pamjeve apo përmbajtjeve të kundërta të cilat frikësohen se janë kundër politikave të tyre nacionale p.sh. në baza morale apo religjioze. Pasi që ekzistojnë shumë internet faqe që ofrojnë propagandë raciste dhe ksenofobike apo pornografi të fëmijëve, brengat e tilla gjithmonë nuk janë të pajustificuara. Pyetja ngritet, megjithatë, sa është i thyeshëm bilanci në mes lirisë së shprehurit dhe mbrojtjes legjitime të intereseve në

shtetet demokratike. Falë natyrës të pakufishme të internetit, përgjigjet mund të gjenden kryesisht në shkallën ndërkombëtare. Në Konventën e tij për Krimin Kibernetik, OBEZH tashmë e ka dënuar pornografinë e fëmijëve dhe ka provuar të shtojë përgjegjësinë e kriminit të organizuar si dhe kooperimin ndërkombëtar për ndjekje; puna në një protokol shtesë që merret me racizëm dhe propagandën ksenofobike është në progres. Konventa ende nuk ka hyrë në fuqi.

Samiti i Kombeve të Bashkuara për Shoqërinë Informativë në Gjenevë në vitin 2003 dhe në Tunis në vitin 2005 merret edhe me një çështje tjetër me rëndësi të veçantë.; përfshirjen dhe përjashtimin në kohën e komunikimit, të thirrur po ashtu ‘koha digjitale’. Qëllimet e mëdha për të zhvilluar një plan të veprimit se si të mbyllet hapësira ndërmjet “esnafëve” dhe “të thjeshtëve” të qasjes në teknologjitë e informimit dhe komunikimit. Pasi që i ashtuquajturit digjital që ndan veriun dhe jugun (por po ashtu në veri, ku regjionet rurale dhe ato më pak të përparuara janë lënë mbrapa) vazhdon të zgjerohet me shpejtësi, është e nevojshme një kohë e gjatë për ta gjetur linjën globale të veprimit. Liria e të shprehurit është në thelb e prekur nga refuzimi i përfshirjes në infrastrukturën informative, për arsye se rritja e rëndësisë së internetit e bën gati të pamundur që me aq lehtësi të korrigojë apo përhap idetë në çdo vend.

Për çdo rast duhet të theksohet se nuk mund të ketë liri pa përgjegjësi dhe liritë e pakufizuara mund të shkaktojnë shkelje të të drejtave të njeriut, siç është e drejta e intimitetit. Por frenimet duhet të justifikohen nga qeveria për arsye legjitime, të cilat mund të shqyrtohen me kujdes nga opinioni publik, dhe si burim i fundit, institutet juridike.

## **2. PËRMBAJTJET DHE KËRCËNIMET**

Liria e të shprehurit është një e drejtë-kornizë e cila përmban disa elemente, si liria e informimit dhe liria e shtypit dhe liria e mediave në përgjithësi. Është bazuar mbi të drejtën e opinionit dhe është në brendësi i lidhur me të. Paraqitjet e saj radhiten nga shprehja individuale e opinionëve deri te liria institucionale e mediave. Liria e opinionit

është një e drejtë absolute civile, ndërsa liria e të shprehurit është e drejtë politike, e cila mund të jetë subjekt i disa ndalesave.

Liria e të shprehurit është një e drejtë e dyfishtë në sensin e lirisë për të ndikuar p.sh. shprehja e opinioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, dhe liria për të kërkuar dhe pranuar informata dhe ide, të dyja në çdo formë – gojarisht, me shkrim apo të shtypura, në formë të artit, apo nëpërmjet çfarëdo lloji të mediave, përfshirë këtu edhe teknologjitë e reja. Kufijtë nuk mund të përdoren për të ndërhyrë në këtë të drejtë. Si pasojë, liria e të shprehurit është një pjesë përbërse e “*të drejtës për komunikim*”. Një deklaratë për këtë të drejtë tashmë është skicuar, por pasi që është një përpilim i të drejtave ekzistuese të njeriut (siç është, jashtë lirisë së të shprehurit, të drejtës së lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit, e drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe e drejta për intimitet) më parë se një e drejtë e re, koncepti nuk është ende i qartë.

#### **Elementet kryesore të lirisë së të shprehurit:**

- Liria që për mbajtjen e opinioneve pa ndërhyrje (liria e opinionit)
- Liria për të kërkuar, marrë dhe ndarë informatat dhe idetë (liria e të shprehurit, liria e informimit)
  - Gojarisht, me shkrim, me shtyp dhe në formë të artit
  - Nëpërmjet të gjitha mediave (liria e mediave)
  - Pa i marrë parasysh kufijtë (liria e komunikimeve ndërkombëtare)

#### **BURIMI**

NENI 19 DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT (DUDN),  
NENI 19 KONVENTA NDËRKOMBËTARE MBI TË DREJTAT CIVILE DHE  
POLITIKE (KNDCP);

NENI 10 KONVENTA EVROPIANE MBI TË DREJTAT E NJERIUT, NENI 4  
DEKLARATA AMERIKANE E TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË NJERIUT  
(DADDN), NENI 9 KARTA AFRIKANE MBI TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË  
DREJTAT E NJERËZVE (KADNDn).

**Elemente të caktuara të të drejtës së shprehurit janë po ashtu të lidhura me të drejtat e njeriut, p.sh:**

- E drejta e lirisë së menduarit, ndërgjegjes dhe religjionit ( Neni 18 KNDCP)  
Moduli i lirive religjioze
- E drejta autoriale që të përfitojë nga mbrojtja e interesit moral dhe material nga ndonjë prodhim shkencor, letrar apo artistik, p.sh. e drejta e autorit (copyright) (neni 15(2) KNDESK).
- Në lidhje me të drejtën e njeriut për arsimim ( Neni 12 KNDESK), liria e të shprehurit rezulton në liri akademike dhe autonomi e institucioneve të larta të mësimit në mënyrë që t'i mbrojnë ato të drejta.

Një kualifikim i madh i të drejtës së të shprehurit është në përmbajtjen e Nenit 20 të KNDCP, i cili ndalon propagandën e luftës dhe çdo lloj avokimi të urrejtjes nacionale, racore apo religjioze e cila përmban nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë. Shteti është i detyruar të fuqizojë këto ndalesa me legjislaturë nacionale.

Moduli i mosdiskriminimit.

**Shkelja e të drejtave, kërcënimet dhe rreziku**

Në praktikë, ne jemi dëshmitarë të shkeljeve të gjera të të drejtave të njeriut përmes ndalimeve të lirisë së të shprehurit dhe mediave në shumë shtete të botës siç mund të shihet nga raportet e hershme të *Amnesty International* apo *Vëzhgimi i të drejtave të njeriut (Human Rights Watch)*. sipas *Reporterëve Pa Kufij* , 31 gazetarë gjatë kryerjes së detyrës së tyre janë vrarë dhe 489 janë burgosur në vitin 2001. Organizata atëherë propozoi instrumente speciale legale siç është “*Karta e Sigurisë e Punës së Gazetarëve në Zonat e Luftës apo Regjioneve të Rrezikshme*”.

“*Lufta kundër terrorizmit*” pas 11 shtatorit të vitit 2001 ka sjellë kërcënime të reja për lirinë e informimit nga qeveri të ndryshme. Për shembull, shoqata e shkrimtarëve, PEN-i, nxitu rishikimin e aktit PATRIOT të SHBA-ve. Mirëpo, liria e shprehjes dhe e mediave po ashtu mund të keqpërdoren që të kurdisin urrejtjen dhe konfliktin siç ishte dokumentuar ng Federata Ndërkombëtare e Helsinkit në publikimet mbi “*gjuhën e urrejtjes në Ballkan*”.

Është një kërcënim i cenzurës, e cila mund të shfaqet në formë të cenzurës shtetërore apo cenzurës përmes metodave ekonomike apo të tjera. Kjo do të thotë se artikujt mund të botohen vetëm pas provimit nga autoriteti siç ishte praktikuar në shumicën e vendeve të Evropës Lindore para përfundimit të luftës së ftohtë në vitin 1989. Po ashtu mund të nënkuptohet se interesi ekonomik mund ta ndalojë publikimin e opinioneve të caktuara, për shembull nëse industria ushtarake ndalon artikujt me një qëndrim kritik kundrejt luftës.

Cenzura mund të shfaqet edhe me vetëcenzurë, kur interesat politike apo të tjera merren parasysh nga gazetari apo drejtori i mediave. Së fundi, vendimi për vlerën e lajmeve, çka “është e përshtatshme për shtyp” mund të heqë informatat të cilat nuk shihen si të përshtatshme, çështjet e minoriteteve apo çka nuk bëjnë mirë.

Vendimet se çka duhet të publikohet shpesh mund të jenë të diskutueshme. Kodet e praktikave të mira mund të japin orientimin. Përndryshe, qëllimi i pluralizmit medial është të sigurojë se këndvështrime të kundërta mund të lexohen. Dëgjohen apo shihen.

### **Kufizimet legjitime të së drejtës**

Sipas nenit 29 të deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut ushtrimi i të drejtave dhe lirive të çdonjërit është subjekt i kufizimeve si është e përcaktuar me ligj, në vend “*me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe lirive të të tjerëve...*”. Neni 19(3) KNDKP na rikujton se të drejtat e renditura mbajnë në vete detyrime dhe përgjegjësi speciale. Kjo tregon se liria e të shprehurit dhe e mediave është një e drejtë shumë e ndieshme, e cila duhet të menaxhohet me një kujdes të duhur. Detyrat dhe përgjegjësitë nuk janë të përfshira në konventë, por shpesh ato gjenden në kodet e etikës profesionale apo legjislacionin shtetëror, i cili, megjithatë, nuk duhet ta ndalojë përmbajtjen e të drejtave njerëzore. Detyrat tipike dhe përgjegjësitë ndërlidhen me detyrën e informimit objektiv, p.sh. të kërkosh të vërtetën apo së paku lejo opinione të tjera.

Disa përgjegjësi përfundojnë me arsytet për ndalesa për të drejtën e shprehjes., ku nuk ka asnjë ndalesë legjitime për lirinë e të menduarit.

Sipas Nenit 19 (3), tri lloje të ndalesave janë të mundshme, të forcuara të cilat janë të mjaftueshme nëpërmjet legjislacionit dhe është konsideruar e nevojshme:

- Për respektimin e të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve
- Për mbrojtjen e sigurisë nacionale apo rregullit publik (public order)
- Për mbrojtjen e shëndetit publik apo moralit

Sipas rregullave të interpretuara juridike, kufizime e të drejtave duhet të interpretohen në mënyrë restriktive, p.sh. e drejta themelore nuk mund të nënkuptohet dhe restriksionet nuk duhen të jenë më të mëdha sesa është e nevojshme që të mbrojnë të drejtën e të tjerëve dhe të mirat themelore publike, siç është përmendur.

Në nenin 10 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, lista e ndalesave të mundshme është edhe më e gjatë edhe pse me precize. Ajo shpall se ushtrimi i lirisë së të shprehurit mund të jetë subjekt i *“kushteve, ndalesave dhe dënimeve (gjobave), siç është e shkruar me ligj dhe janë të nevojshme në shoqërinë demokratike”*. Këto ndalesa mund të justifikohen nga:

- *“interesat e sigurisë nacionale, integritetit teritorial apo sigurisë publike,*
- *për parandalimin e çrregullimeve apo krimin, për mbrojtjen e shëndetit apo moralit*
- *për mbrojtjen e reputacionit apo të drejtës së të tjerëve,*
- *për parandalimin e zbulimit të informatave të marra në besim,*
- *për mbajtjen e autoritetit dhe objektivitetin e juridiksionit.”*

Asnjë e drejtë tjetër nuk ka një listë kaq të gjatë të arsyeve për shpjegime. Megjithatë, dy parakushte të mëdha duhet të përmbushen, në mënyrë që të legjitimohen ndalesat e të drejtës. Përjashtimet duhet të jenë:

- të parapara me ligj
- të nevojshme në shoqërinë demokratike.

“*Të parapara me ligj*”, do të thotë se ndalesat duhen të jenë vendim i parlamentar dhe jo një urdhër ekzekutive nga qeveria. Me rëndësi të veçantë është definimi: “*të nevojshme në shoqërinë demokratike*”. Kjo ndërlidh lirinë e të shprehurit dhe të mediave me konceptin e një shoqërie të hapur dhe pluraliste, e cila qeveriset me mjete demokratike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka qenë shumë e rreptë në kërkesat e tilla, siç mund të shihet nga i ashtuquajti **rasti Lingens**. Në vitin 1986, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasbourg vendosi që politikani duhet të pranojë një shkallë më të lartë të kritikizmit sesa një qytetar i thjeshtë dhe nuk mund ta bëjë gazetarin të heshtë, me arsye të nevojës për mbrojtjen e reputacionit të tij. Në përputhje me rrethanat, ligji mbi **shpifjet**, i cili lejon po ashtu të ndiqen gazetarët të cilët kritikojnë personat në pozicione publike, duhet të jetë i balancuar me lirinë e shtypit.

### 3. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Është një larmi e madhe e instrumenteve dhe procedurave për zbatimin e të drejtës së njeriut të lirisë së të shprehurit dhe të drejtave të saj përbërëse. Së pari, është obligim i shteteve të përfshijnë liritë në ligjet e tyre vendore dhe të ofrojnë mjete kompensimi në rast të shkeljes me paramendim. Në përputhje me rrethanat, e drejta mund të gjendet në shumicën e kushtetutave si pjesë e katalogut të të drejtave dhe të lirive themelore. Standardi minimal rrjedh nga obligimet ndërkombëtare universale dhe, kur ekzistojnë, në shkallën rajonale.

Po ashtu, ligjet dhe rregulloret e ndryshme të mediave dhe të komunikimit janë shumë të rëndësishme. Ata më tutje saktësojnë të drejtën dhe ndalesat e saj në praktikën jetësore, në përputhshmëri me obligimet ndërkombëtare dhe me ligjin kushtetues nacional. Ato mund të bëjnë instrumente kombëtare të monitorimit – si këshillat mediale apo të shtypit – për të rregulluar në veçanti mediat, të cilat shumë shpesh janë të kompozuar nga ekspertët dhe/ose nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Në mënyrë që të rregullohet

sektori i mediave, për të siguruar standarde kualitative dhe për të stimuluar konkurrencën, shteti mund të lëshojë **licenca**, të cilat duhet të hartohen mbi baza jodiskriminuese.

Pëlqimi i monitorimit nga shteti është një detyrë e disa mekanizmave të kontrollit dhe të monitorimit. Për shembull, nën Konventën e KB mbi Mbrojtjen e të Drejtave Civile dhe Politike (KKBMDCP), shtetet kanë obligim të dorëzojnë raportet shtetërore në periudha të rregullta (çdo pesë vjet) mbi zbatimin e obligimeve të tyre, të cilat janë konsideruar të bëhen nga Komisioni i KB mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Ata dhanë një interpretim të Nenit 19 në Komentimin e Përgjithshëm Nr. 10 të vitit 1983. Komisioni, po ashtu, mund të pranojë **komunikime**, p.sh. ankesa nga individët, në qoftë se shteti përkatës nuk e ka ratifikuar Protokolin e Parë Fakultativ të KKBMDCP të vitit 1966 ( 104 nga 149 shtete e kanë ratifikuar deri në vitin 2002).

**Mekanizmat rajonale të mointorimit** si sistemi interamerikan apo afrikan mund të ofrojnë komunikime individuale për komisionet, të cilat mund të japin konkluzë dhe rekomandime. Në rastin e sistemit evropian dhe interamerikan, gjykata mund të marrë vendim, i cili i detyron shtetet që të garantojnë kompensimin. Në parim, është një *“procedurë e monitorimit e këshillit të ministrave”*, e cila ndër të tjera mbulon lirinë e të shprehurit dhe të informatës në shtetet anëtare.

Të gjitha konventat parashohin mundësinë e *“ankesave të shteteve”*, të cilat vërshtirë mund të përdoren.

Përveç procedurave të zakonshme, ka edhe procedura të ashtuquajtura si ato të bazuarat në karta si ajo e **Raportuesit Special mbi Promovimin dhe Mbrojtjen e Lirisë së Opinionit dhe të Shprehurit**, i cili i raporton Komisionit të KB mbi të drejtat e njeriut për situatën e lirisë së të shprehurit anembanë botës dhe jep observime, rekomandime dhe komente mbi elementet e të drejtave të njeriut.

Për 55 anëtarët e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), përfaqësuesi për lirinë e mediave është emëruar në vitin 1997. Mandati i tij është që t'i

ndjekë zhvillimet në sektorin e mediave të shteteve pjesëmarrëse, në mënyrë që të promovojë media të lira dhe pluraliste, të cilat janë vendimtare për një shoqëri të hapur dhe të lirë dhe për një sistem të përgjegjshëm së qeverisë, i bazuar në obligime ndërkombëtare dhe standardet e OSBE-së, të miratura në konferenca të vazhdueshme dhe në takime të ekspertëve që nga Akti Vendimtar i Helsinikut të vitit 1975.

### **Roli i Asociacioneve Profesionale dhe OJQ-ve të tjera.**

Asociacionet profesionale si Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve, Instituti Ndërkombëtar i Shtypit (INSH), Internacional P.E.N. apo Asociacioni Ndërkombëtar i Publicistëve (ANP) kanë informata të rëndësore mbi shtetin dhe lirinë e mediave në shtete të ndryshme të botës dhe i mbështesin anëtarët e tyre kundër kufizimeve. Ata tërheqin vëmendjen drejt situatave ku këto liri janë të shpërfillura, dënojnë kufizimet, lansojnë fushata po apele të shpejta veprimi dhe përgatisin raporte mbi probleme të veçanta si përqendrimi i mediave, sekretet shtetërore dhe transparenca sipas rregullores mbi Lirinë e Informimit, apo korrupsionit. Duke bërë kështu, ata mbështeten nga OJQ-të e specializuara për mbrojtjen e lirisë së shtypit dhe e mediave si meni 19 apo si Reporterët Pa Kufij (shih listën e instituteve në *“Informatat Shtesë”*) si dhe OJQ për të drejtat e njeriut të përgjithshme si Amnesty International apo Këshili Ndërkombëtar mbi Politikën e të Drejtave të Njeriut. Për më shumë, ata bashkëpunojnë me organizatat ndërqeveritare dhe institutet e tyre speciale, si Raportuesi Special i KB mbi Lirinë e të Shprehurit dhe Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave.

Trupat e instituteve të monitorimit apo asociacionet profesionale dhe OJQ-të gati gjithmonë kanë për qëllim parandalimin e shkeljes së të drejtave njerëzore, ligjet për shpifje dhe praktika të tepruara, të cilat mund t'i ulin zërat e gazetarëve kritikë.

## **4. PERSPEKTIVAT NDËRKULTURORE DHE ÇËSHTJET KONTRAVERSE**

Dallimet kulturore çojnë në pluralizëm të zbatimit të të drejtave. Krahasuar me SHBA-të, Evropa dhe shteteve e tjera kanë qëndrim tjetër në raste të fjalimit urrejtjenxhtës me të cilin sulmohet dinjiteti i një grupi. Evropa nuk e toleron avokimin e urrejtjes nacionale,

racore apo religjioze e në veçanti antisemitizmin, propagandën nacistë apo mohimin e holokaustit, dhe forma të tjera të ekstremizimit të krahut të djathtë, kurse kjo është më së paku e mbuluar nga liria e shprehjes (amandamentit i parë) në Kushtetutën e SHBA.

Nganjëherë **ndarjet delikate** mund të shihen nga rasti i GJEDNJ i quajtur *Jersid kundër Danimarkës*, ku gjykata e dënoi gazetarin, i cili e kishte emituar një intervistë me racistë të rinj, të cilit bënin deklaratë raciste, dhe kjo ishte një shkelje e Nenit 10 i KEDNJ të lirisë së informimit, ndërsa ata të cilët bëjnë deklaratat nuk u mbrojtën nga Neni 10.

Sipas “*doktrinës së tepricës së vlerësimit*” të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, edhe në mes shteteve evropiane ka hapësirë për dallime. Kjo është e një rëndësie të veçantë për mbrojtje të moralit të rëndësishëm të fjalës, literaturës dhe emetimit të konsideruar si pornografik. Çështja e mirësjelljes apo mbrojtjes së përmbajtjes së dëmit të vogël, i është lënë shtetit, i cili shpesh përdor instrumente të pavarura që të udhëheqë mediat për këtë çështje.

Standarde të ndryshme po ashtu provokojnë kritikën publike të politikanëve apo instituteve religjioze. Për shembull, çka është **liria artistike**, e cila mund të konsiderohet si e tillë nga disa, kurse nga disa të tjerë konsiderohet si blasfemi. Si pasojë, liria e të shprehurit dhe e mediave është një e drejtë shumë e ndieshme, e cila duhet të respektojë kufij të veçantë, por gjithashtu duhet të mbrohet kundrejt tendencave të shteteve që të influencojë personat me kritika ndaj tyre.

Në shtetet aziatike kufizimet e ashpra të lirisë së shprehurit dhe mediave për një kohë të gjatë janë justifikuar mbi parimin e mbajtjes së stabilitetit të vendit, i cili ishte kërcënuar nga “*raportimi i papërgjegjshëm*” i shtypit që nxiste konflikte politike. Megjithatë, sikurse në seminarin ASEM të mbajtur në vitin 2000, i cili merrej me temën për dialogun evroaziatik, u pa se qeveritë janë të prira të reagojnë jashtë mase dhe kështu të shkurtojnë lirinë e mediave më shumë seç duhet. Probleme të përbashkëta si koncentrimi i mediave apo mungesa e pavarësisë së gazetarëve janë më të mëdha sesa dallimet rajonale. Në raste të kontesteve, është përgjegjësi e gjyqësisë së pavarur që të tërheqë një kufi të drejtë në

mes të lirisë së shprehurit dhe mediave dhe të legjitimitojë kufizimet për të mirën e stabilitetit të shtetit demokratik dhe intergjetit moral të personit, i cili është bërë subjekt i akuzave të pabaza të mediave.

Për shembull, në Bosnjë e Hercegovinë pak vite pas përfundimit të luftës civile, një gazetë publikoi emrat e të akuzuarve kinse për krime të luftës. Kjo menjëherë u ndalua nga autoritetet, për shkak të rrezikut se këta persona të cilët ende nuk ishin akuzuar zyrtarisht, mund të bëheshin subjekt i hakmarrjes personale.

Në rastin e *Projektit të së Drejtës Kushtetuese, Organizata e Lirive Civile dhe Agjenda e të Drejtave Mediale kundër Nigerisë, Komisioni Afrikan mbi të Drejtat e Njeriut dhe Popujve* kishte të bëjë me dëbimin e gazetave nga një dekret ekzekutues nga qeveria ushtarake e Nigerisë, e cila ishte drejtuar kundër opozitës. Komisioni vërtetoi se:

*“dekretet si ky shkaktojnë rrezik serioz për publikun, për të drejtën për t’u informuar jo në pajtim me çka do të kishte dashur qeveria që publiku të dijë. E drejta për pranimin e informatave është e rëndësishme : Neni 9 ( i Kartës Afrikane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Njerëzve) nuk shihet se e lejon uljen e të drejtave, pa marrë parasysh temën e informatave apo opinionit dhe pa marrë parasysh situatën politike të vendit. Prandaj, komisioni vlerësoi se mbyllja e gazetës ishte një shkelje e Nenit 9(1).*

[Raporti i Trembëdhjetë i Veprimeve i Komisionit Afrikan mbi të Drejtat e Njeriut dhe Njerëzve 1999-2000, Shtojca V, paragrafi 38).

Lidhur me masën kundër gazetarëve pas kupës në Gambi, Komisioni vlerësoi se:

*”frikësimi dhe arrestimi apo ndalimi i gazetarëve për artikujt dhe çështjet e publikuara heq jo vetëm të drejtën e gazetarëve që lirshëm të shprehen dhe të shpërndajnë opinionet e tyre, por po ashtu i heq edhe publikut të drejtën për informim. Ky veprim është qartë një shkelje e dispozitave të nenit 9 të Kartës.”*

[Raporti i Trembëdhjetë i Veprimeve i Komisionit Afrikan mbi të Drejtat e Njeriut dhe Njerëzve 1999-2000, Shtojca V, paragrafi 65).

## **KRONOLOGJIA**

- 1948** Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- 1966** Konventa e KB mbi të Drejtat Civile dhe Politike
- 1978** Deklarata e UNESCO e Parimeve Themelore në lidhje me kontributin e Mediave për Forcimin e Paqes dhe Mirëkuptimit Ndërkombëtar, për Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe kundërvënies ndaj Nacizmit, Aparteidit dhe Nxitjes për Luftë.
- 1979** Komenti i Përgjithshëm nga Komisioni i të Drejtave të Njeriut mbi Nenin 19 të KNDCP.
- 1993** Raportuesi Speciali i KB mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtës së Lirisë së Opinionit dhe të Shprehurit.
- 1999** Rezoluta e Komisionit mbi të Drejtat e Njeriut për Lirinë e Opinionit dhe të Shprehurit 91996/36)
- 2003** Samiti Ndërkombëtar Botëror, pjesa e parë në Gjenevë
- 2005** Samiti Ndërkombëtar Botëror, pjesa e dytë në Tunis

## **E DOBISHME TË DIHET**

### **1. ROLI I MEDIAVE TË LIRA PËR SHOQËRINË DEMOKRATIKE**

*>>Informimi është oksigjen i demokracisë.<<*

#### **NENI 19 (OJQ NDËRKOMBËTARE E vendosur NË LONDËR)**

Pluralizmi i mediave është një element i domosdoshëm i demokracisë pluraliste. Rëndësia e rregullave për mediat, për të ashtuquajturën “*fuqinë e katërt*”, përveç fuqive të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësisë kërkon, po ashtu, një vëmendje të veçantë dhe përgjegjësi nga gazetarët dhe pronarët e mediave që të mos shkelin të drejtat e njeriut të tjerëve, duke i ushtruar liritë e tyre.

Moduli i Demokracisë.

Liria e një shoqërie të caktuar lehtë mund të përcaktohet nga liria e shtypit dhe e mediave. Hapi i parë që zakonisht e ndërmarrin qeveritë autoritare apo diktatoriale është shkurtimi apo persekutimi i lirisë së të shprehurit dhe mediave.

Është me rëndësi të madhe për rikonstruktimin dhe rehabilitimin e shoqërive demokratike pas luftës dhe konflikteve, një sistem pluralist i mediave, i cili punon mbi bazën e respektit dhe tolerancës për opinionin e të tjerëve dhe për shmangien e nxitjes për urrejtje dhe dhunë.

*>>Mediat kanë një rol qendror në demokraci për të informuar publikun dhe për të shqyrtuar udhëheqjen e çështjeve publike pa frikë që do të jenë të ndjekura, të paditura apo të shtypura.<<*

**KEVIN BOYLE, BASHKËTHEMELUES I NENIT 19 PËR: NDALIMET MBI LIRINË E TË SHPREHURIT, 2000.**

Kjo kërkon një kornizë të duhur ligjore e cila siguron pavarësinë e mediave publike dhe pluralizmin në mesin e atyre private, dhe po ashtu monitoron aktivitetet e mediave në përputhshmëri me standardet e objektivitetit, paanësisë dhe mirësjelljes.

### **3. MEDIA DHE MINORITETET**

Minoritetet shumë shpesh përballen me probleme të qasjes në media dhe për të pasur media në gjuhët e tyre. Në Evropë ekzistojnë standarde speciale të detyrimeve të bazuara në nenin 19 të KNDCP dhe neni 10 i KEDNJ, p.sh. në Nenin 9 të Konventës Kornizë Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit Evropian të vitit 1995. Sipas saj, edhe personat që u përkasin pakicave etnike kanë lirinë e opinionit dhe të shprehjes. E drejta e tyre për të kërkuar, pranuar dhe shpërndarë informata apo ide në gjuhët e minoritare, pa marrë parasysh kufijtë duhet të respektohet nga autoritete publike. Qeveritë duhet të sigurojnë se personat që u përkasin pakicave kombëtare nuk janë të diskriminuara në qasjen mediale, e cila duhet të jetë e lehtë. Ata nuk duhet të ndalohen për krijimin e mediave të tyre dhe, sipas ligjit, të posedojnë media elektronike. Standarde të mëtejme ekzistojnë në kornizën e OSBE-së. Situata, megjithatë, është më shumë problematike sa u përket të ashtuquajturave minoritete të reja të cilat rrjedhin nga

migrimet. Ndryshe nga pakicat “e vjetra” kombëtare, ata nuk i kanë të garantuara në mënyrë legale të drejtat që u sigurojnë qasje në media. Kjo është shqetësuese kur merren parasysh mënyra ksenofobike në të cilën shumë herë janë portretizuar në media, kurse mundësitë e tyre për kundërdeklarata janë refuzuar.

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale të Minoriteteve e Këshillit Evropian e vitit 1992 në Nenin 11 ua parashtron palëve shtetërore që të marrin masa adekuate në mënyrë që emetuesit të cilët ofrojnë programe në gjuhët e minoriteteve të sigurojnë që të kenë qasje, të inkurajojnë dhe/ose të lehtësojnë krijimin e së paku një radiostacioni dhe një kanali televiziv në gjuhët rajonale të minoriteteve.

### **3. LIRIA E MEDIAVE DHE ZHVILLIMI EKONOMIK**

Liria e mediave dhe zhvillimi ekonomik janë të lidhur sikurse liria nga frika dhe liria nga kërkesa. Ndërvlarshmëria dhe pandashmëria e të gjitha të drejtave të njeriut që kërkon një qasje joformale ndaj të drejtave të njeriut në përgjithësi mund të shihet po ashtu në rëndësinë e lirisë së të shprehurit dhe lirisë së mediave për zhvillim ekonomik, ngritje nga varfëria dhe plotësim të të drejtave themelore sociale dhe ekonomike të njerëzve. Pa një raportim nga media për të metat në qasje apo redistribuim të burimeve, korrupsioni mund të mbetet i pahetuar.

*>>...kurrë nuk do të kishte krizë substanciale në një shtet me formë demokratike të qeverisjes dhe një shtyp relativisht të lirë.<<*

**AMARTYA SEN,**  
ÇMIMI NOBEL PËR EKONOMI

*>>kur u deklarua lufta, e vërteta është fatkeqësia e parë.<<*

**ARTHUR PONSONBY,**  
POLITIKAN BRITANIK, 1871 – 1946

*>>Fjalët vrasin së pari, plumbat më vonë”.*

**ADAM MIHNIK, SHKRIMTAR POLAK**

#### **4. PROPAGANDA E LUFTËS DHE PREDIKIMI I URREJTJES.**

Sipas nenit 20 (1) KNDCP çdo propagandë e luftës duhet të ndalohet me ligj. Sipas kësaj, mediat duhet të bartin një pjesë të përgjegjësisë për luftërat në ish-Jugosllavi, kur ato propagandonin luftë apo nxisnin urrejtje dhe spastrime etnike.

Transmetimi i *Radio Mille Kollinsit* është zbuluar se ka pasur një rol të madh për dhunën e Ruandës në vitin 1994, gjatë së cilës më shumë se një milion njerëz janë vrarë. “*mos i vrisni ata inyezi (kacabunji) me plumba – ciopëtojini në pjesë me hanxhar*” ishte njëra nga deklaratat e emetuara, duke i thirrur hututë që t’i vrisnin tutsit dhe hututë që kishin simpati për çështjen tutsi. Radio ishte themeluar në vitin 1993 nga anëtarët e familjes të presidentit Habajaramina të Hutuve, vdekja e të cilit ishte njëra ndër arsyet e shumta për shpërthim të gjenocidit. Shumica e gazetarëve të përgjegjshëm për këtë luftënxitje të Radio Mille Kollinsit u arrestuan pas krizës.

Çdo predikim për urrejtje nacionale, racore apo religjioze që përmban nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë duhet të ndalohet me ligj.

NENI 20 (2) KNDCP

#### **5. PRAKTIKA TË MIRA**

- UNESCO ka iniciuar Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit dhe Ditën Ndërkombëtare të Çmimit të Lirisë që mbahet më 3 Maj.
- Projekti i krimeve të luftës i sjell së bashku gazetarët, avokatët dhe akademikët që të ngrisin vetëdijësimin e lihdjeve të luftës ndërmjet mediave, qeverisë dhe të OJQ-ve humanitare dhe të të drejtave të njeriut. ([www.crimesofwar.org](http://www.crimesofwar.org)).
- Në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, u themelua një Komision i Pavarur i Mediave, që më vonë i thirrur Agjencia për Rregullimin e Komunikimit (ARRK) i cili nëpërmjet të Këshillit dhe Panelit të Fuqizimit monitoron dhe zbaton standardet përmbajtësore në “kodin e emetimit” të tyre. Ky, po ashtu, udhëheq licencimin. Ombudspersoni i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, në vitin 2001 raportoi se ishin duke e shikuar për së afërmi procesin dhe në disa raste

kishin ndërhyrë për hir të transparencës dhe kushteve të barabarta për të gjithë aplikuesit. ARRK pranon se rekomandimet e tyre kishin një ndikim pozitiv te publiku dhe te gazetarët.

- Me iniciativën e Republikës së Austrisë, Këshilli i Bashkimit Evropian, më 20 Maj të vitit 2000 mori vendim mbi masat e marra për luftën kundër pronografisë së fëmijëve në internet.

## **6. LIRIA E MEDIAVE DHE ARSIMIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

*“Brenda gazetarisë ka një mungesë të madhe të njohurive se çka janë të drejtat e njeriut. Shumë gazetarëve, si edhe shumë politikanë dhe të tjerë të cilët punojnë në shoqërinë civile, nuk janë të informuar për Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe për traktatet dhe mekanizmat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Shumë shpesh ata nuk e kuptojnë dallimin ndërmjet të drejtave të njeriut dhe të drejtave të luftës. Si rezultat, të drejtat e njeriut shumë shpesh shihen gabimisht si relevante vetëm gjatë raportimit në një konflikt”.*

### **BURIMI:**

KËSHILLI NDËRKOMBËTAR MBI POLITIKAT E TË DREJTAVE TË NJERIUT, GAZETARISË, MEDIAVE DHE SFIDAVE TË RAPORTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT, 2002.

*Asociacioni Ndërkombëtar i Botuesve (ANB), i cili përfaqëson 78 institute në 65 vende, në komentet e tija mbi Dekadën e KB mbi të Drejtat e Njeriut për Arsimin, nënvizoi rëndësinë e ngritjes së aktiviteteve të vetëdijësimit përsa i përket lirisë së të shprehurit dhe lirisë për të publikuar.*

### **BURIMI:**

RAPORTI I KOMISIONERIT TË LARTË TË KB MBI TË DREJTAT E NJERIUT PËR ZBATIMIN E DEKADËS SË KB MBI TË DREJTËN E NJERIUT PËR ARSIMIM, E/CN.4/2003/100.

## **7. TRENDET**

### **Mediat dhe Interneti**

Sipas raportit të zhvillimit njerëzor të KB të vitit 2001, përdorimi i internetit është rritur gjatë viteve të kaluara nga 16 milion përdorues në vitin 1995 në më shumë se 400 milion në vitin 2000. Në vitin 2005 më shumë se 1 miliard njerëz do ta përdorin internetin. Rritja e internetit në botë ka pasur një ndikim të madh në media, duke ofruar një llojllojshmëri të zgjedhjeve të reja për të dyja palët- gazetarët dhe publikun. Madje, edhe një ndërmarrje e vogël mediale ka shansë që të arrijë publikun global sot. Tani është më lehtë që t'i shmangeni kontrollit shtetëror dhe censurës.

### **Rritja e mediave në shtetet në zhvillim**

Gjatë 30 viteve të kaluara, shtypi i gazetave të përditshme në shtetet në zhvillim gati është dyfishuar: në vitin 1996, 69 nga 1000 njerëz e kanë pasur kopjen e tij – krahasuar me 29 në vitin 1970. Krahasuar me shtetet në zhvillim, ku një pjesë e njerëzve që e lexojnë gazetën ditorë është zvogëluar dukshëm nga 292 nga 100 në vitin 1970 në 226 në vitin 1996, kjo e dhënë nuk është ende e knaqshme, por mbetet si shënim. Rritja e qasjes krijon një treg të ri dhe më efikas të ideve, mbi të cilin është e arritshme një llojllojshmëri më e gjerë e opinioneve dhe e pikëpamjeve. Informatat mund të publikohen dhe të tërhiqen më lehtë, duke ofruar kështu baza stabile për strukturat demokratike dhe për qeverisje të mirë.

## **AKTIVITETE TË ZGJEDHURA**

### **1. AKTIVITETI 1: BALLINA**

#### **PJESA 1: HYRJE**

Ky është një akt dramatik i një grupi të këshilltarëve të cilët punojnë për ta bërë gati ballinën e gazetës për shtyp. Pjesëmarrësit do të diskutojnë për improvizimin e hulumtimit të çështjeve për censurën, stereotipet dhe objektivitetin në media.

**Lloji i aktivitetit:** improvizim i aktit dramatik

## **PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME MBI AKTIN DRAMATIK**

### **Qëllimet dhe synimet:**

- Që të reflektojë mediat dhe qasjen e tyre ndaj të drejtave të njeriut.
- Që të hulumtojë dhe reflektojë senzacionalizmin, stereotipet dhe objektivitetin në media.
- Të identifikojë mekanizmat e censurës dhe problemet e lirisë së të shprehurit dhe mediave.

**Grupi i synuar:** të rinjtë dhe të rriturit

**Madhësia e Grupimit / organizimi shoqëror:** 8 - 25

**Koha:** rreth 90 minuta

**Përgatitja:** Zgjidh një ballinë të një gazete lokale apo ndërkombëtare

**Aftësitë e përfshira:** komunikimi, mendimi kritik dhe analitik.

## **PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR PJESËN TEATRORE**

### **Hyrje në temë:**

- Shpjego se është një simulim i grupit punues mbi të drejtat e shtypit dhe kufizimet e tij, i cili do të jetë i transmetuar përmes stacionit të TV.

Informo pjesëmarrësit se diskutimi do të bazohet mbi disa ballina që ju i keni mbledhur për të ilustruar më mirë mendimet dhe ua tregoni të gjithëve.

Cakto një grup njerëz për aktin dramatik:

- Një aktivist i të drejtave të njeriut: Ai/ajo vë në pah karakterin e dyfishtë të mediave. Në njërën anë, mediat raportojnë për shkelje të të drejtave të njeriut, megjithatë në anën tjetër, ata vetë bëjnë shkelje të të drejtave njeriut: duke shpërndarë akuza të pabaza apo duke nxitur urrejtje. Aktivisti do të theksojë deklaratën e tij/saj nëpërmjet tregimeve dhe shembujve të ballinave.

- Gazetari: Ai/ajo do të betohet për të drejtat e njeriut, për lirinë e të shprehurit dhe për lirinë e mediave. Ai/ajo do të flasë për nevojën e mediave të lira, duke raportuar mbështetjen e tij/saj për disa tregime të shembujve të ballinave. Çka nëse njerëzit kurrë nuk kanë lexuar për tregime të tilla? Gazetarët kanë obligim që të hulumtojnë dhe t'i mbajnë lexuesit e tyre të informuar.
- Regulluesi shtetëror i mediave: Ai/ajo me ngulm do t'i theksojë kufizimet e lirisë së të shprehurit dhe të mediave. Ato shfaqen në konflikt me të drejtat e tjera siç është e drejta për intimitet. Ai/ajo do të rikujtojë përgjegjësitë e shtetit, si mbrojtës, dhe rolin special të autoriteteve, si kryetari, udhëheqësit shpirtëror dhe partia në pushtet apo policia.
- Moderatori: Ai/ajo do të udhëheq diskutimin mbi të drejtën e shtypit dhe do të bëjë pyetje për pjesëmarrësit. Ai/ajo do të thirrret në shembujt e ballinave që të marrë përgjigje konkrete.

Tash, pjesëmarrësit për aktin dramatik i sillni së bashku në një rreth dhe lejo moderatorin që të fillojë diskutimin. Ai/ajo duhet të mbyllë diskutimin pas 30 minutash.

### **Vlerësim**

Bashkoi të gjithë sërish. Tash vazhdo mbi reflektimin e aktit dramatik në ngritjen e disa pyetjeve për diskutim:

- Çka konsideroni ju problemin kryesor të së drejtës së shprehurit dhe lirisë së mediave?
- Çfarë forma mund të marrë cenzura, në rastin e cenzurës publike apo private?
- A keni përjetuar ndonjë formë të cenzurës apo vetëcenzurës në jetën tuaj?
- Pse është kaq e rëndësishme e drejta për opinion, për shtyp dhe për media?
- Çka mund të bëhet më mirë për t'i mbrojtur këto të drejta?
- A ka persona po institute që nuk mund të kritikohen?
- A duhet të lejohen forma të veçanta të cenzurës në mënyrë që të ruajnë (demokracinë) stabilitetin, paqen religjioze, besimin ndëretnik etj.?

### **Këshilla metodologjike:**

Sa më kujdesshëm që t'i zgjidhni ballinat, aq më i gjallë do të jetë akti dramatik dhe diskutimi. Së pari vendos a do t'i marrësh gazetat lokale apo ato ndërkombëtare. Mundohu t'i gjesh disa me piktura, mundësisht të shkruara në stil tërheqës.

### **Sygjerime për ndryshim**

Përdor artikujt e gazetave me fotografi. Ndaji fotot nga titujt dhe nxiti pjesëmarrësit që të qëllonjë se cila fotografi i takon cilit nen. Përfshiji edhe ata në diskutim.

### **PJESA IV: VAZHDIMI**

Shumë radio apo TV lokale kanë mundësi të sigurojnë transmetimet e tyre për grupet e komuniteteve. Puno në projekte grupore, të cilat do të hulumtojnë dhe do të prodhojnë një program televiziv për çështjet në interesin e tyre. Përdore kryetitullin si “*Mendo globalisht, vepra lokalisht*” apo ngjashëm.

### **Të drejtat e ndërlydhura / fusha të tjera të hulumtimit:**

E drejta për lirinë e të menduarit, të opinionit dhe shprehjes, e drejta për zhvillim, jetë dhe shëndetësi, e drejta për intimitet.

## **2 AKTIVITETI II: NDIKIMI I INTERNETIT**

### **PJESA I. HYRJE**

Ky aktivitet përfshin një diskutim plenar të një grupi të vogël i cili analizon aspektet pozitive dhe negative të përdorimit të internetit, ndërlikimet mbi të drejtën e të shprehurit dhe sfidat për të ardhmen e internetit.

**Lloji i aktivitetit:** diskutim

## **PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME MBI DISKUTIMIN**

**Qëllimet dhe synimet:**

- Që të rrisë vetëdijën për përzierjen e internetit dhe qasjen në informata anembanë botës
- Identifikimi i përzierjeve të internetit mbi të drejtat e njeriut
- Hulumtimi i fenomeneve të ndërlidhura me internetin

**Grupi i synuar:** të rinjtë dhe të rriturit

**Madhësia e Grupimit / organizimi shoqëror:** kushdo

**Koha:** rreth 45 minuta

**Përgatitja:** Kopjet e doracakëve (shih me poshtë)

**Aftësitë e përfshira:** aftësi analitike, shprehja e pikëvështrimeve të ndryshme mbi çështjen, aftësi ekipore

### **PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE MBI DISKUTIMIN**

#### **Hyrje në temë:**

Prezanto aktivitetin duke ofruar njohuri të përbashkëta, i jep grupit disa fakte themelore për internetin, p.sh. siç është e përshkruar në modul; pastaj kërko nga ata që të bisedojnë në çifte për përvojat e tyre me internetin dhe përparësitë dhe pengesat e përdorimit/mospërdorimit. Kjo të zgjasë dhjetë minuta.

#### **Procesi i diskutimit:**

Shpërdajua kopjet e doracakut. Duke u bazuar në doracak, diskuto për ndikimin e internetit, të këqijat e tij, por edhe për përparësitë, duke i përdorur pyetjet në vijim:

- A dinë pjesëmarrësit për të drejtat e njeriut dhe shkeljen e tyre nëpërmjet internetit (siç është pornografia e fëmijëve, krimi kibernetik)?
- Pse këto shkelje kanë një ndikim në rritje mbi shoqërinë?
- Çka mund të bëjë interneti në mënyrë që të parandalojë një gjë të tillë?

Kërko nga një apo dy pjesëmarrës që t'i shkruajnë çështjet kryesore në letër.

#### **Vlerësim:**

Fillo me çka u kanë mësuar pjesëmarrësve për internetin.

- Çfarë njohurish kanë deri më tashi njerëzit për internetin? Sa e përdorin atë? Pse e përdorin atë? Tash shiko se çfarë përparësish janë mbledhur në letër.
- Mati përparësitë e përdorimit të internetit me të këqijat?
- Çka duhet të bëhet që t'i shqyrtojmë të këqijat?

### **Këshilla metodologjike:**

Vlerëso se sa kanë njohuri për internetin pjesëmarrësit para aktiviteti, në mënyrë që ju të zgjedhni nivelin e qasjes së përgjithshme. Në vlerësim, është një ide e mirë që të fokusoheni në çështjet globale dhe lokale të qasjes në teknologjinë e re informative, duke siguruar se ata të cilët nuk kanë fare qasje në internet apo kanë probleme do ta ngrenë zërin.

### **Sygerime për ndryshim**

*“Interneti për të drejtat e njeriut”* mund të bëhet si ndryshim apo vazhdimësi e aktiviteti. Mblidh informata mbi organizatat e ndryshme të të drejtave të njeriut në nivelin ndërkombëtar dhe atë lokal. Në qoftë se ka mundësi qasju internetit, shtyp faqet e tyre të internetit dhe ua shpërndaj kopjet. Pyeti njerëzit për dijen e tyre në këto organizata. Krahaso aktivitetet e tyre dhe promovimin e tyre me internet. Në bazë të këtyre të dhënave, diskuto përparësitë më të rëndësishme apo përdorimet e internetit për promovimin e të drejtave të njeriut.

### **PJESA IV: VAZHDIMI**

Inkurajo pjesëmarrësit që të vizitojnë faqet e internetit të organizatave mbi të drejtat e njeriut. Ato pastaj mund të reflektojnë për projektimin e

- përdorimit të burimeve të internetit për të rritur vetëdijësimin për çështjet e të drejtave të njeriut në fqinjësi të tyre.
- krijimit të faqes së tyre të internetit dhe të lidhjes me organizata të tjera rinore që të luftojnë për të drejtat e njeriut në veçanti dhe për rrezikun në komunitetin e tyre.

**Të drejtat e ndërlidhura / fusha të tjera të hulumtimit:**

Çdo e drejtë tjetër e njeriut.

**BURIMI:**

MIRATUAR NGA: KOMPAS: DORACAK PËR ARSIMIMIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT ME TË RINJ. PUBLIKIME TË KËSHILLIT EVROPIAN: STRASBOURG.2002.

**Broshura:**

**HELMIMI I FAQEVE TË INTERNETIT: URREJTJA E DREJTPËRDREJTË**

Interneti në veçanti është zhvilluar me shpejtësi që nga krijimi i *Stormfrontit*, faqja e parë e urrejtjes ekstremiste, në vitin 1995, dhe zhvillimi i tij nuk tregon ndonjë shenjë të zvogëlimit. Një numër i madh i njerëzve hyjnë drejtpërdrejt, dhe shumica janë të pambrojtur nga masa e fanatizmit - qëndrimet e tyre dhe sjelljet janë besueshëm të ndikuara nga prezenca keqdashëse dhe e apeleve të fshehta.

Shfaqja e një grupi të faqeve me përmbajtje të urrejtjes sidomos nga gra ekstreme, siç është raca e tyre, *Femrat për Bashkimin Arian, dhe Kisha Botërore e Krijuesit të kufirit të Femrës*, lajmëron zhvillimin e ri të urrejtjes së drejtpërdrejtë. Duke bërë thirrje dhe duke punuar që t'i definojnë rolet e tyre në "lëvizjen" e mbinjerëzimit të bardhë, këto femra ekstremiste janë në luftë të caktuar të feminizmit për femrat që ta ngritin zërin e tyre kundër qëllimit përçmues për shpërndarjen e dhunës. Disa femra që urrejnë në faqe të internetit, reflektojnë pozitën e nxitur nga meshkujt; opozitë ndaj jo të bardhëve, urrejtjen për martesë të përzierë, dhe mllëfi i kontrollit të mediave nga "kundër të bardhëve".

Nga faqja raciste, e cila ishte ofruar nga *Stormfront*, rrjedh: "Gaja: Nëna e të gjithëve". Ajo deklaron se "të bardhët po përballen me diskriminim për aq kohë sa racat e tjera shumohen dhe invadojnë tokën tonë". Ajo shpall se "të bardhët kanë të drejtë për të pasur më shumë fëmijë sesa të tjerët".

Antisemitistët dhe racistët nuk ishin të vetmit që shpërndanin urrejtjen në internet. *Faqet e internetit anti-homoseksual, anti-abort, dhe anti-qeveri si dhe prezenca e lëvizjeve*

lokale dhe gjyqeve të së drejtes së përbashkët u janë bashkangjitur këtyre drejtpërdrejt, si faqe të minuara të cilat promovojnë ekstremizmin e dhunshëm të të gjitha llojeve.

Luftimi i ekstremizmit të drejtpërdrejtë shfaq një varg vështirësisë juridike dhe teknologjike. Edhe nëse është e levërdishme elektronikisht të mbahen faqet e tilla jashtë internetit, natyra ndërkombëtare e mediumit e bën regullën juridike të pamundur virtualisht.

### **BURIMI:**

HELMIMI I FAQEVË TË INTERNETIT: URREJTJA DREJTPËRDREJT: RAPORTI I ADL PËR FANATIZËM, EKSTREMIZËM DHE DHUNË, PUBLIKIM I ADL, SHBA, 1999.

### **BIBLIOGRAFIA**

Fondacioni Azi-Evropëe. 2000. Seminari i tretë ASEM mbi të drejtat e njeriut. Singapor.

Qendra e Azisë për Informata mediale dhe komunikim. 2000. Mediat dhe të drejtat e njeriut. Singapor. AMIC.

Kevin Boyle. 2000. Kufizime mbi të drejtën e të shprehurit, në: Fondacioni Azi-Evropë (FAE), Seminari i tretë ASEM mbi të drejtat e njeriut. Singapor, 27-37.

Sally Burnheim. 1999. E drejta për komunikim – interneti në Afrikë. Londër: Neni 19.

Riçard Carever. 1995. Kush sundon qiejt – transmetimi në Afrikë. Londër: Neni 19 dhe shtojca mbi censurën.

Jean Pierre Chretien. 1995. Ruanda – Mediat e gjenocidit. Parsi: Karthala.

Stanley Cohen. 1995. Refuzimi dhe njohja: roli i infomimit për shkeljet e të drejtave të njeriut. Jerusalem: Qendra e të drejtave të njeriut, Universiteti i Hebrenjve të Jerusalemit.

Këshilli i Evropës. 2002. Liria e të shprehurit në Evropë, raste sipas nenit 10 të Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut. Strasbourg.

Këshilli i Evropës. 2002. Mediat në shoqërinë demokratike: bashkërendimi i lirisë së të shprehurit me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Konferencë. Luksemburg: 30 shtator 1 tetor 2002.

<http://www.coe.int/medialuxemburge>.

Qendra e Emiratave për Hulumtime dhe studime strategjike. 1998. Revolucioni informativ dhe bota arabe- ndikimi në shtet dhe në shoqëri. Londër: I.B. Tauris.

James Fallows. 1997. Lajm i ri – si e ka rrënuar Media Demokracinë Amerikane. New York: Vintage.

Antonio Freire. 1999. El Kike, la Checchi, La Elvira, El Gonzato y El Malo: La Tevedecada de los Noventa Santiago de Chile: Ediciones Eace.

Goff, Peter (ed) 1999, Lajmet e Kosovës dhe Propaganda e Luftës, Vjenë, Instituti Ndërkombëtar i Shtypit;

Roy Gutman dhe David Rieff. 1999. Krimet e Luftës – Çka shkollat publike duhet të dinë. New York” WW Norton.

Filip Hammond dhe Eduard Herman . 2000. Mundësia e degraduar – Mediat dhe kriza e Kosovës. Londër: Shtypshkronja Pluto.

Kristof Hejns. 2002. TË drejtat civile dhe politike në kartën afrikane, në: Malkolm D. Evans dhe Rejçell Murrej, Karta Afrikane Mbi të të Drejtat e Njeriut dhe të Njerëzve, Sistemi në Praktikë, 1986 – 2000. Shtypi Universitar i Kembrixhit, 137 –177, 164ff.

Human Rights Watch. 1988. Kufijtë e tolerancës: Liria e të shprehurit dhe debati publik në Kil. LOM.

John Keane. 1991. Mediat dhe Demokracia. Kembrixh: Shtypi i politikave.

Mariana Lenkova. 1998. Fjalimi i urrejtjes në Ballkan, Athinë: Federata Ndërkombëtare e Helsinikut.

Rob Mek Re. 2001. Siguria Njerëzore, Lidhshmëria dhe Shoqëria e re Civile Globale, në librin e Rob Mek Re dhe Don Hubert, Siguria njerëzore dhe diplomacia e re. Shtypi Universitar Mek Gill Queens, 236-249.

Susan D. Moeller. 1999. Dhembshuria e lodhshme- si i shesin mediat sëmundjet, urinë, luftën dhe vdekjen. New York: Routledge.

Manfred Novak. 1994. Komente mbi Konventën e KB mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Shtypi universitar i Blumingtonit. Indiana.

Robert I. Rotheberg dhe Tomas Uaiss. 1996. Prej Masakrës në gjenocid- media, plotikat publike dhe krizat humanitare, Uashington D.C.: Shtypi Institucional i Brukingsit.

Eduard Said. 1997. Duke mbuluar islamin: Si mediat dhe ekspertët përcaktojnë se si ne e shohim pjesën tjetër të botës. Londër: Vintage.

Komisioni i të Drejtave të Njeriut i Afrikës Jugore. 2000. Gabimet – kërkimi i racizmit në media. Johannesburg.

Mirjana Todorovic. 2003. Liria e të shprehurit dhe e drejta për dinjitet dhe reputacion, në librin Kultura e të drejtave të njeriut. Qendra e të drejtave të njeriut Beograd. 161 – 175.

Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara . 1999. Mediat dhe të drejtat e fëmijëve- Hyrje praktike për profesionistët e mediave. Londër: PressUise, 1999.

Hern Uribe. 1999. La invisible Mordaza: Tregu kundër Mediave. Kil: Cuarto Proprio.

Klaud E. Uelsh. 1998. Karta Afrikane e Lirisë së të Shprehurit. Qendra e të drejtave të njeriut Bufalo. Pasqyra 4.

Aidan Uitë. 2002. Gazetaria, Liritë civile dhe lufta mbi terrorizmin, raporti final mbi ngjatjet e 11 shtatorit dhe përzierja për gazetarinë dhe liritë civile. Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve.

## **INFORMATA PLOTËSUESE:**

**Institucionet dhe asociacionet relevante.**

**Qendra e Mediave të Femrave të Afrikës:**

<http://www.awmc.com>

**Qendra e Informatave Mediale dhe Komunikimit e Azisë:**

<http://www.amic.org.sg>

**Projekti i Krimeve të Luftës:** <http://www.crimesofear.org>

**Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve:** <http://www.ifj.org>

**P.E.N. International:** <http://www.interpen.org>

**Asociacioni Ndërkombëtar i Publikuesve (ANP):**

<http://www.ipa-ue.org>

**Fondacioni i Mediave për Afrikën Përendimore:**

<http://www.mediafoundationwa.org>

**Reporterët pa Kufij, Raporti vjetor 2002:**

<http://www.rsf.fr>

**Organizata e Mediave të Evropës Juglindore (OMEJL):**

**Reporterët pa Kufij, Raporti vjetor 2002:**

<http://www.rsf.fr>

[freedia.at/seemo](http://freedia.at/seemo)

**Grupi Këshillues i Lirisë së Shtypit i UNSECO:**

[http://www.unesco.org/webworld/fed/temp/communication\\_democracy/group.htm](http://www.unesco.org/webworld/fed/temp/communication_democracy/group.htm)